



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 07.11.2019, ora 13.00

Drejton mbledhjen

Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutim mbi qëndrimet e Presidentit të Republikës lidhur me procesin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.

Marrin pjesë :

- | | |
|---------------------|---------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha` | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 6. Fatjona Memçaj | (anëtare) |
| 7. Margarita Buhali | (anëtare) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, përfaqësues i Avokatit të Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit.

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se në mbledhje nuk është e pranishme anëtarja e Këshillit, znj. Arta Marku, e cila ka njoftur pak para fillimit të mbledhjes për angazhimin në një takimishumë të rëndësishëm me institucione ndërkombëtarëve, që nuk mund të shmangej, ndaj edhe e ka të pamundur të jetë prezent në fillimin e mbledhjes.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutim mbi qëndrimet e Presidentit të Republikës lidhur me procesin e plotësimit të vendeve vakante në Gjykatën Kushtetuese.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen më çështjen e caktuar në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani informon se sipas rregullave të funksionimit të Këshillit për çështjet diskutojnë njëherë anëtarët e Këshillit dhe pastaj i kërkohet mendimi Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuar. Nëse jeni dakort, mund të veprimë ndryshe këtë radhë, meqenëse ka ardhur një shkresë e gjatë e argumentuar e Presidentit të Republikës. Ndoshta është më mirë të dëgjojmë përfaqësuesin e Presidentit, nëse ai e vlerëson dhe sa e vlerëson të parashtrojë, dhe pastaj të vazhdojmë diskutimin. Ka ndonjë problem të veprimë në këtë mënyrë?

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shtron pyetjen se ka vendimmarrje për të marrë Këshilli? Ideja është nëse ka një vendimmarrje, rrada mund të ishte kjo. Nuk mund të marrë vendime Këshilli për një organ tjetër.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shpjegon se edhe të kishte vendimmarrje, përveç këtij argumenti, meqenëse është një dokument në këtë rast, e dëgjojmë, sepse ne e kemi të shkruar, zoti Dervishaj është këtu dhe mundet ai ta vlerësojë e të thotë atë që mendon të thotë dhe aq sa ai mendon të thotë dhe pastaj të vazhdojmë diskutimin. Dakord?

Anëtarët e Këshillit miratojnë këtë radhë diskutimi.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se faktikisht unë nuk do zgjatem të lexoj letrën e Presidentit të Republikës, që mban datën 05.11.2019, të cilën ia ka drejtuar Kryetarit të Kuvendit, Avokatit të Popullit dhe Kryetarit të KED-së, mbi vendimmarrjen e tij paraprake, për shqyrtimin e kandidaturave e që do të përzgjedhë më pas një prej tyre për të qenë anëtar i Gjykatës Kushtetuese. Lepra është e gjatë. Ka brenda saj arsyetim ligjor, ka edhe në fund një vendimmarrje të tij, të mbështetur në dispozitat e vlerësuara nga Presidenti i Republikës. Ai ka marrë tre vendime, paraprakisht të pezullojë procesin administrativ, nuk po vijoj më tutje ta citoj të gjithë paragrafin, t'i kërkoj KED-së plotësimin e praktikës dokumentare që vetë Këshilli në Raportin e tij të Arsjetuar ka thënë që nëqoftëse u nevojitet ua sjellim dhe të kërkoj bashkëpunimin e Kuvendit për futjen në seancë plenare në një kohë sa më shkurtër të zgjedhjes së anëtarit të dytë të Gjykatës Kushtetuese. Kur morëm njoftimin e djeshëm për tu paraqitur në këtë mbledhje, faktikisht unë u habita pak nga objekti i rendit të ditës, diskutim mbi qëndrimin e presidentit, sepse prisja të paktën, më së paku që Këshilli të diskutonte për plotësimin e praktikës së kërkuar, asgjë tjetër. Mendojmë ne si Presidencë që nuk na anatemohet dhe as të vlerësohet vlerësimi ligjor kushtetues që Presidenti i Republikës ka bërë për kompetencën e tij dhe ushtrimin e saj. Nuk është në tagrin e Këshillit. Pasi anëtarët e Këshillit të diskutojnë, kjo është e drejtë e Këshillit, unë mund të mbaj komente të tjera, por për momentin ky është komenti parimor.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani shpjegon se titullimi i çështjes së rendit të ditës, diskutim për qëndrimin e përcjellë nga Presidenti i Republikës lidhet pikërisht me 3 momente. Pra me pezullimin e afateve sipas procedurës, kërkesën për plotësim të praktikës dhe ftesën apo hapat që mendon ai të kryejë për bashkëpunimin me Kuvendin. Mund t'ju them paraprakisht se nuk do të ishte nevoja fare për të bërë mbledhje për dërgimin e dokumentacionit, sepse kjo nuk është ndonjë çështje për të vendosur. Madje mund t'ju them që praktika dokumentare është gati dhe, nuk e di, ndoshta është përcjellë në këtë moment, sepse ne e kemi thënë që në Raportin e Arsjetuar, të miratuar që nëse e vlerësoni ua përcjellim në çdo kohë dhe në atë masë sa ju e çmoni të nevojshme. Por pa hyrë në detajet e përmbajtjes, gjithësesi është përcjellë një qëndrim i cili në një farë mënyre do të kërkoj një shkresë përgjigje, cilado qoftë përmbajtja e saj edhe ashtu si thotë zoti Bledar, nuk ka rëndësi,

nuk mund ta them se cila është përmbajtja e shkresës paraprakisht. Por e nisur vetëm nga unë si Kryetar, pastaj përsëri, ashtu si thuhet në letrën e Presidentit të Republikës, mund të kontestojë Kryetarin se ku e gjeti autoritetin të më kthejë këtë përgjigje. Për këtë arsye unë e vlerësova edhe në cilësinë si Kryetar të thërras mbledhjen dhe ta diskutoj edhe këtë moment me Këshillin. Pra kjo ishte për ta sqaruar.

Fatri Islamaj merr fjalën dhe shprehet se së pari ju falënderoj për vënien në dijeni për këtë shkresë. Brenda shkresës konstatoj që ka pasur dhe komunikim tjetër me Presidentin e Republikës, pasi janë dërguar listat. Sipas shkresës konstatohet një komunikim që ka pasur kërkesë për informacion për të cilën.....

Ardian Dvorani ndërhyr dhe shpjegon se Institucioni i Presidentit, nuk e përmendi z. Bledar, por nuk ka rëndësi, kërkonte informacion çfarë ka ndodhur me përcjelljen e listave, kërkonte një informacion nëse i janë përcjellë apo jo listat Kuvendit.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë lidhur me letrën e dërguar nga Presidenti i Republikës dhe dakordësohen me qëndrimin se kërkesa që adreson Presidenti i Republikës për dërgimin dhe plotësimin e praktikës dokumentare të kandidatëve të lejuar dhe të renditur sipas Listës Përfundimtare të miratuar nga Këshilli, ka gjetur në fakt vullnetin edhe në aktet që ky Këshill ka miratuar, ku është përcaktuar që nëse kërkohen nga organet e emërtesës, u dërgohet menjëherë çdo dokument që Këshilli ka administruar në këto procedura të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe të renditjes së kandidatëve të lejuar për secilin nga vendet vakante për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Dëgimi i këtyre materialeve është çështje e natyrës administrative dhe nuk kërkon vendimarrje të mbledhjes së Këshillit. Përgatitjet për dërgimin e materialeve janë kryer dhe janë duke u përcjellë në Institucionin e Presidentit të republikës. Çështjet e tjera që përmbahen në shkresën e Presidentit të Republikës nuk i adresohen vetëm KED-së por edhe Kuvendit, për efektet të bashkëpunimit që nevojitet në zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Interpretuesi i parë i një kompetence kushtetuese është vetë organi kushtetues dhe secili organ kushtetuesbën interpretimin e normës apo të kompetencës së tij në mënyrë ose në përputhje me vullnetin e tij pa u angazhuar nga organet e tjera. KED-ja tashmë e ka ezauruar detyrimin ligjor në lidhje me këto katër vende vakante dhe ka bërë maksimumin e mundshëm për të qenë korrekt me Kushtetutën dhe ligjin. KED ka shqyrtuar kandidaturat duke realizuar procedurat e verifikimit, ka realizuar procedurat e vlerësimit të kandidaturave duke dhënë vendimet përkatëse për vlerësimin dhe pikëzimin e secilit kandidat të lejuar, ka miratuar Listat Përfundimtare të renditjes së kandidatëve si edhe Raportin e Arsytuar të renditjes për secilën

vakancë dhe ia ka përcjellë tashmë ato dy organeve të emërtesës. Nga ky moment veprimtaria e Këshillit në lidhje me këtë proces është e përfunduar.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe shprehet se unë ndaj të njëjtin mendim me ju për sa i përket kompetencës që ka apo jo ky Këshill për tu shprehur në lidhje me atë çka vendos një organ tjetër kushtetues. Por ajo që mua edhe si syri pa syze i publikut kur jemi në këtë mbledhje, që e kam si kompetencë, nuk arrij ta kuptoj se për çfarë arsye dhe për çfarë qëllimi ka ndodhur një veprim i tillë. Për çfarë arsye Këshilli nuk e ka bërë publik që momentin që i ka dërguar, dhe e kam adresuar tek ju zoti Kryetar, pra përse nuk e ka bërë publik Këshilli që në momentin e parë që ka dërguar listat e emërtesave që e përfundoi punën e vet. Qëllimi kryesor i Këshillit ka qenë pikërisht ky, të përfundonte dërgimin e listave për secilin organ të emërtesës, Nga mbledhja në të cilin u mor vendimi përfundimtar dhe derisa janë dërguar fizikisht në organet e emërtesës nuk ka pasur asnjë komunikim, madje ky komunikim është bërë publik vetëm nga organet e emërtesës dhe jo nga ky Këshill....

Ardian Dvorani ndërhyt dhe shtron pyetjen se ju po thoni që nuk e kemi bërë një komunikat shtypi për këtë? Sepse ato akte janë të publikuar në faqen e KED.

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon duke u shprehur se ato janë në faqen e KED por jo njoftimi a ia keni çuar apo nuk ia keni çuar. Ky është diskutimi. Vendimet kanë dalë më vonë dhe unë i kam parë vendimet. Vazhdojmë të mbetemi në të njëjtat situata me vendimet. Pavarësisht vendimmarrjeve që merren, vendimet nuk janë, nuk përfaqësojnë dhe nuk rezultojnë ato që u thanë të paktën në atë mbledhje të ditës së shtunë që erdhëm që të gjithë, lanë çdo punë tjetër dhe erdhën për të adresuar këtë problematikë që nuk ishte një problematikë e vogël e që ka të bëjë me transparencën dhe me llogaridhënien e Këshillit ndaj të tretëve. Kjo në kuptimin se si janë marrë disa vendime të caktuara që i takojnë, mendoj unë, edhe vlerësimit që na bëjnë të tretët për punën e Këshillit, një punë e jashtëzakonshme që ka bërë ky Këshill dhe mendoja që sigurisht momenti përfundimtar do të ishte fakti që Këshilli e bëri punën e vet dhe ia dërgoi organeve të emërtesës listën përkatëse. Mendoj që ishte një moment që do të duhet të ishte komunikuar me publikun. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme, mendoja unë, që Këshilli kishte për t'ia komunikuar publikut. Për të komunikuar faktin që përfundoi punën e vet dhe ia dërgoi organeve të emërtesës.

Problematika e dytë që evidentohet nga ky dokumentacion, pikërisht edhe nga fakti që nuk u bë publik se kur u dërguan, ka të bëjë me një moment tjetër kushtetues. Për çfarë arsye ka pasur një dërgim të vonuar në kohë të të dy listave, ashtu siç unë nuk e kuptoj se përse të dyja vakancat janë dërguar në të njëjtën kohë qoftë Presidentit, qoftë Kuvendit. Nuk e kuptoj logjikën pas kësaj çështje. Sigurisht kërkova nëse kishte apo nuk kishte një

vendimmarrje të ndryshme por nuk ka asnjë gjë në faqen e KED-së për ndonjë veprim i tillë apo shkak të tillë dhe ndoshta ka një logjike shumë të drejtë mbas kësaj. Nëse mundeni z.Kryetar të na e shpjegoni që të kuptojmë se për çfare arsye jemi në një situatë të tillë. Formimi i Gjykatës Kushtetuese dhe emërimi i këtyre anëtarëve është bërë një nga problemet thelbësore të këtij vendi. Nuk është një problem i vogël. Përmendet në çdo fjalë, në çdo conference, në çdo diskutim dhe sigurisht anëtarët e Këshillit, mendoj se dhe ne si vëzhgues apo kushdo prej nesh, ka një peshë shumë të madhe për t'i shpjeguar publikut se reforma në drejtësi po funksionin dhe se këto procedura janë procedurat e duhura të ndjekura në kohën më të shpejtë të mundshme, për të garantuar cilësinë e duhur të vendimmarrjes qoftë nga ana e Këshillit, qoftë nga ana e organeve të tjera, pra të faktorëve të tjerë që për hir të së vërtetës, siç dhe ju e keni shprehur, janë përgjegjës dhe po përgjigjen për të adresuar këtë problematikë.

Unë e kam shprehur dhe në mbledhjen e fundit që kemi pasur që ky nuk është një proces, në të cilin secili prej këtyre tre aktorëve që është pjesë e procesit të emërimit të anëtarëve të Gjykatës së Kushtetuese, qoftë KED-ja, qoftë Presidenti i Republikës, qoftë Kuvendi dhe Gjykata e Lartë, kur të vijë Gjykata e Lartë në këtë rol, pra janë katër aktorë, e thashë gabim, nuk janë tre në fakt, janë katër grupe të ndryshme të cilët duhet të prodhojnë këtë produkt, nuk mendoj se duhet të funksionojnë dhe ta shikojnë punën e tyre të ndarë dhe veçmas njëri nga tjetri. Duhet të ketë një bashkërendim të kësaj pune pikërisht për faktin se qëllimi është një. Asnjëri prej këtyre organeve në mënyrë të mëvetshme nuk ka kompetencë për ta krijuar Gjykatën. Por ama të gjithë së bashku duhet t'ia bëjmë punën të lehtë tjetrit. Ne për shkaqe të pavaruara nga ky Këshill, nuk kemi mundur që ti paraqesim organeve të emërtesës zgjedhje të mjaftueshme për të bërë, për të plotësuar detyrimet e tyre kushtetuese. A duhet ne t'ia vështirësojmë dhe më shumë punën? Do të ishte pyetja ime. Unë mendoja që secili prej organeve dhe KED duke treguar dhe rolin e një organi të specilizuar dhe me anëtarësi, në gjykimin tim ndoshta modest, me emrat nga më të shquar të sistemit të drejtësisë, do duhet ta kryente, në gjykimin tim, këtë punë me përgjegjshmërinë që ligji i njeh në kuptimin e thelbit, jo vetëm të letrës së ligjit. Pra, e bëra unë këtë, e dërgoj unë këtë, e kam kompetencën, unë e dërgoj me tre anëtarë, në çastin që e dërgoj unë duhet të kem tre, po ra numri nga tre në dy dhe mua nuk më intereson se unë e nxorra. Pra arritëm të kalojmë në disa çështje dhe disa interpretime që realisht do të vinin në vështirësi secilin prej atyre që e lexojnë produktin përfundimtar që janë qytetarët, që njerezit të mendojnë a e mbarova unë kompetencën time dhe a e nisi kompetencën tjetri dhe nuk ka rendësi a e vë unë në vështirësi apo e vë unë në lehtësi tjetrin për ta kryer punën e vet.

Unë e kam menduar gjithmonë që puna e Këshillit kaq voluminoze, kaq e madhe, kaq profesionale dhe, në këtë moment në gjykimin tim, që nuk bëj opinion me diskutime shumë të vogla, po të isha unë që do të jepja një vlerësim do të mendoja që është bërë një punë e jashtëzakonshme dhe shumë e mirë me problematika të cilat, në fakt, të ngritura që nga ne nxorren dhe problematikat në përfundim. Ky Këshill nëse shkon kjo radhë që u diskutua sot, i bie që ka vendosur Këshilli se kush do të jenë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Të paktën e ka lënë Kuvendin pa zgjedhje. Kuvendi nuk do mund të zgjedhë. Kuvendi do të zgjedhë o A-në o B-në në vakancën e parë, ose A-në o B-në në vakancën e dytë. Kjo është e vërteta. A e ka ky Këshill këtë kompetencë? Mua më duket qartësisht se ky Këshill këtë kompetencë nuk e ka.

Kalojmë në pikën e dytë. A ka ndonjë mundësi, numri i vakancave se këto ishin emrat, ne nuk mund të shpikim emra të tjerë, pra a kishte mundësi Këshilli që t'ia mundësonte dhe t'ia lehtësonte sa më shumë të ishte e mundur punën organeve të emërtesës? Këtu mendoj se Këshilli ka pasur mundësi për t'ia lehtësuar punën ose për të bërë atë që është detyra e vet, t'i jepte zgjedhje organeve të emërtesës, në maksimumin e mundësive të veta. Por jo t'ia përkeqësonte dhe përkeqësimi mua më mbetet ose më vë një pikëpyetje jo të vogël në këtë proces. Këto janë mendimet e mia në lidhje me këtë çështje. A do të duhet të ishte bërë publik moment dhe tani mund të mos ketë fare rëndësi, por kur e shikoj tani, e kuptoj shkakun që përse nuk keni bërë njoftim publik që përfundoj procesi dhe që KED-ja e mbaroi punën e tij dhe dërgoi emrat. Sepse po ti mbanim ne emrat këtu do kishte vlerë z.Kryetar? Po ju pyes ju. Po ti mbanim emrat ne e mos ti dërgonim asnjëherë, ti mbanim emrat në KED, këtu brenda Gjykatës se e kishte mbaruar Këshilli punën e vet, vendimi i fundit i Këshillit ishte pikërisht vendimmarrja dhe caktimi i listave përfundimtare dhe e renditjes. Po ti kishim lënë këtu për gjashtë muaj, çfarë do ndodhte? ...

Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se kjo nuk mund të ndodhë me ne këtu sepse ...

Erinda Ballanca ndërhyr dhe shprehet se nuk mund të ndodhi, po ne vajtëm tre javë dhe çuam ca në tre, ca në katër, prandaj them....

Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se nuk ka ndodhur dhe kjo nuk mund të ndodhë. Çështja e komunikatës është një gjë, po çështja e dërgimit të listave është tjetër. Listat janë dërguar. Po përse do të shtrojmë pyetjen, po sikur t'i mbanim? Kjo është një pyetje që nuk mund të bëhet!

Erinda Ballanca merr fjalën dhe vijon duke u shprehur se debati është se ne kemi përfunduar punën tone, thotë Këshilli, në momentin që bëri miratimin përfundimtar. Po e diskutojmë këtë dhe po them nëse ne shkojmë dhe e interpretojmë deri në fund a e mbarojmë

punën tonë atëherë? Kjo ishte për të çuar diskutimin në absurd. Sigurisht që jo, se ky ishte një argument që sigurisht as unë nuk e mendoj se nuk ishin për tu çuar asnjëherë listat, as nuk më shkon mendja. Por diskutimi që po bëjmë është në linjën dhe në frymën e asaj që a duhet secili organ kushtetues ta ushtrojë detyrën e vet në mënyrë thelbësore për të dhënë produktin më të mirë në kuptim të frymës Kushtetuese për organin tjetër, apo duhet t'ia bëjë për t'ia vështirësuar sa më shumë punën organit tjetër. Kjo ishte ajo që unë kisha një si pikëpyetje dhe sot e kam shumë të vështirë të mendoj që nuk ka qenë i qëllimshëm fakti që nuk janë bërë publike data e dërgimit të listave organeve të emërtesës. Tani që ndodhi që po vjen kjo letër dhe po vjen kjo çështje dhe po vjen ky moment, në qoftë se Kuvendi do ta kishte ushtruar në mënyrë më të shpejtë të drejtën e vet, të kishte zgjedhur, ta kishte zënë vendin e parë që ti jepte mundësi Presidentit të Republikës ta zgjidhte, në gjykimin tim, ta zgjidhte nga ato emrat që ishin vakancat e vendit e dytë, ta zgjidhte, mendoj se nuk do të kishte problem për të diskutuar këtë gjë. Por sot kur e shikojmë, Kuvendi po e çon në maksimumin e afatit të vet 30 ditor përzgjedhjen, ndoshta i bie s'jemi përpara, jemi në pamundësi që organi i Presidencës të zgjedhi i treti apo të i katërti kut ti bjerë radha. Ndërkohë që Kushtetuta thotë duhet të zgjedhin ata njëherë. Atëherë mos jemi ne në këtë gjë, që e çuam Presidentin e Republikës të mos e ushtrojë të drejtën e vet për të zgjedhur, por të shkoj i pari i listës? Më lind pyetja mua dhe kjo pyetje, jam e bindur që do t'ju lind edhe shumë juristëve të tjerë kur ta lexojnë çështjen dhe a do ta minonte kjo realishtë gjithë këtë punë kaq të madhe që ka bërë ky Këshill?

Për mua realisht ky është shqetësimi thelbësor, që rezultati përfundimtar, qoftë edhe për një çështje tërësisht procedurale apo administrative, edhe nëse kjo do të ishte e vërtetë, ngre të tilla dyshime thelbësore në gjithë procesin dhe gjithë reformën në drejtësi, sa realisht më lë pa fjalë. Për hir të dedikimit shumë të madh të gjithë anëtarëve në këtë proces, edhe timit personal, nuk mund ta them për hir të së vërtetës se ky proces më ka kushtuar pak kohë dhe orë nga puna dhe nga jeta ime. Nuk kam asnjë merak se kjo çështje është detyra ime. Unë e kam bërë. Por sigurisht që secili prej nesh kur e bën një detyrë dhe kur e bën me kaq ndershmëri dhe me kaq dedikim sa e ka bërë gjithë ky Këshill, të çojnë në rezultate në të cilat, në gjykimin tim, realisht mund të çenojnë frymën tërësore të reformës në drejtësi. Unë këto kisha si mendimet e mia dhe sigurisht nëse do të mendonit që mund të më përgjigjeshit ndoshta do të kisha dhe një mundësi për ta kuptuar më mirë procesin se siç e lexoj tani e lexoj vetëm në këtë mënyrë.

Ardian Dvorani, në përgjigje të komenteve dhe pyetjeve që iu drejtuan, shprehet disa pyetje me drejtohen mua, por unë, e vetmja gjë që mund të them, është vetëm kjo që sigurisht

ju jeni e lirë të parashtroni qëndrimet tuaja këtu. Është fare normale dhe ju dhatë argumentet tuaja dhe në linjat e asaj që ka përcjellë qëndrimet edhe Presidenti i Republikës. Mua më duket korrekte dhe ajo linja që parashtroni..., por po të jap unë një përgjigje pastaj do të kaloja në atë që praktikisht e thanë të gjithë anëtarët, do të kaloja në vlerësimin tim për argumentet që ka parashtruar Presidenti i Republikës dhe unë këtë nuk mund ta bëj për momentin. Në mënyrë të pashmangëshme do të argumentoja nëse qëndrojnë apo jo vlerësimi që ka bërë Presidenti, sepse nuk mund të këtë një përgjigje tjetër....

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se pyetjet ishin të miat që i kam adresuar që në momentin e parë, a ka pasur apo jo një deklaratë publike të Këshillit.....

Ardian Dvorani ndërhyt dhe shprehet se nuk ka një komunikatë. Dakord, ju mendoni që është një problem shumë i madh. Mund të jetë. Nuk ka ndonjë komunikatë, por listat janë dërguar dhe këtë nuk e ve njëri në dyshim dhe ky fakt u bë publik. Me komunikatë apo pa komunikatë kjo gjë ndodhi. Nuk ka pasur edhe ndonjë intension për të mos bërë komunikatë, por u përcollën. Kaq mund të them unë për momentin.

Erinda Ballanca ndërhyt dhe shprehet se unë e kuptoj por përse janë përcjell në këtë mënyrë, është pyetja ime?

Ardian Dvorani merr fjalën dhe përgjigjet se nuk ka asnjë motiv. Kjo është çështje thjesht administrative, e volumit të punës, nuk dua t'ju fut këtu në situatën se çfarë ndodh në Gjykatën e Lartë. Këtu nuk ka vërtetë gjyqtar, por ju duhet ta dini se këtu fotokopjohen çdo ditë mijëra e mijëra faqesh dosjesh, të cilat kërkohen edhe nga KPK-ja, nga KPA-ja dhe nga KLGJ-ja. Dhe jemi në një situatë shumë të vështirë. Përfshi edhe Këshillin pastaj që ka edhe ai pjesën e vet. Unë nuk e di se çfarë t'ju them më se çfarë ndodh këtu. Dhe mendoni sikur të ishin edhe gjyqtarë në detyrë, po kjo është një çështje e jona, pra të gjykoheshin edhe çështjet. Nuk e di si do të përballohej me këto kapacitete njerëzore, me këtë infrastrukturë dhe me këtë teknologji që ne kemi. Ky është dhe një moment i përkohshëm, çështja e procesit të rivlerësimit kalimtar. Por mund tju them që këtu është një kantier i madh fotokopjimi, plus që ka dhe gjëra të tjera që ndodhin. Edhe për këtë arsye ndodhin dhe momentet e kësaj natyre. Por nuk ka motive. Kaq mund të them. Më vjen keq, por jo se unë nuk kam vullnet, aq më tepër që jemi të një profesioni, për të bërë dhe diskutime juridike. Por nuk mund ta bëj këtë gjë në pozicionin që jam sepse nuk do të shkonte, dashur pa dashur unë personalisht do të hyja në përfaqimin ose jo të argumenteve që ka parashtruar Presidenti i Republikës dhe që nuk është as qëllimi im për ta thirrur këtë mbledhje dhe për ta pasur këtë çështje në rendin e ditës.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe parashtron se edhe Kuvendit të Shqipërisë i ka mbërritur letra e Presidentit të Republikës drejtuar Kryetarit të Kuvendit. Është njohur me vendimmarrjen e Presidentit të Republikës për pezullimin e procedurës administrative për shqyrtimin e listave dhe praktikës dokumentare për vëndet vakante të Gjykatës Kushtetuese të shpallur nga Presidentit të Republikës më datë 04.03.2019 dhe me kërkesën e tij për bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë në lidhje me këto procedura. Kuvendi i Shqipërisë për hir të së vërtetës ka qenë i hapur për çdo lloj bashkëpunimi dhe nuk është bërë pengesë apo procedura që ka ndjekur Kuvendi është pengesë për një vendimmarrje të Presidentit të Republikës.

Gjejmë rastin që të falenderojmë dhe të vlerësojmë pikërisht punën e KED-së, ajo punë voluminoze që është bërë pjesë e së cilës kemi qenë edhe ne si përfaqësues të Kuvendit në mbledhjet e Këshillit. Kuvendi ka filluar procedurat në respektim të Kushtetutës dhe në respektim të ligjit të organik për organizimin dhe funksionim e Gjykatës Kushtetuese, si dhe në respektim të Rregullores që ka vetë Kuvendi për mënyrën e organizimit dhe funksionit të saj. Eshte zhvilluar seancë dëgjimore. Fillimisht që kur ka ardhur shkresa me dy vendimet e KED-së, vendimi nr.130 dhe vendimi nr.131, ku përmbante listën e kandidatëve për vëndet vakant të shpallura nga Kuvendi më datë 12.02.2018 dhe ajo 03.04.2019, ka bërë publike si në seancë plenare për të gjithë deputetët, në seancë plenare të rradhës, sepse është detyrim i parashikuar nga Rregullorja e Kuvendit, ashtu dhe në faqen e Kuvendit. Natyrisht janë bërë publike dhe në media, pikërisht dërgimi i shkresës së Kuvendit, po ashtu dhe të Presidentit të Republikës. Kuvendi, duke respektuar pikërisht atë afat kushtetues të parashikuar nga neni 125 i Kushtetutës dhe parashikuar nga neni 7/c, pika 5 të ligjit për organizimin dhe funksionimit e Gjykatës Kushtetuese, ka bërë seancë dëgjimore me tre kandidatë, pasi njëri nga kandidatët që ishte në listën e parë, z.Besnik Muçi, u dekretua nga Presidenti i Republikës. Së shpejti, në fillim të javës, Kuvendi i Shqipërisë ka caktuar seancën plenare ku do zgjedhë dy nga anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Kuvendi gjykon që kjo procedurë që po ndjek në lidhje me zgjedhjen e anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, si organ i emërtesës për ato dy vende vakante, është në përputhje me Kushtetutën dhe me ligjin “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ashtu dhe me Rregulloren e Kuvendit. Kuvendi do të respektojë pikërisht afatin 30 ditor, të cilin e konsideron si një afat prekluziv, i cili nuk mund të pezollohet, as nuk mund të zgjatet dhe në këto kushte, brenda afatit 30 ditor, do të zgjedhë dy anëtarët e Gjykatës Kushtetuese. Ka mbaruar seanca dëgjimore, është bërë mbledhje, është përgatitur raporti, janë bërë dhe projekt vendimet dhe i janë paraqitur seancës plenare. Në mbledhjen e parë të seancës plenare do kalojnë në procedurën e votimit. Gjykoj që kjo

procedurë që po zhvillon Kuvendi nuk është pengesë dhe nuk pengon të drejtën e organit tjetër të emërtesës, siç është Presidenti i Republikës, që në bazë të listës së ardhur nga KED-ja të zgjedhë, të emërojë anëtarin e Gjykatës Kushtetuese, brenda afatit të parashikuar në Kushtetutë. Edhe për pretendimin e Presidentit të Republikës në lidhje me zbatimin e nenit 179 pika 2, Kuvendi gjykon dhe vlerëson në këndvështrimin e atij interpretimi që e parashikon Kushtetuta....

Ardian Dvorani ndërhyr dhe shprehet se anëtarët po më thonë që edhe mund të mos i diskutoni këto, pasi është problem i juaji. Solla me mikrofon reagimin e anëtarëve.

Mimoza Arbi merr fjalën dhe vijon duke u shprehur se kjo është procedura. Jemi në procesin e zgjedhjes së dy anëtarëve.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe parashtron se kam dy gjëra të vogla, më shumë për saktësim. Nisur dhe nga qasja e Këshillit, unë nuk do të hyj në detaje të shkresës. Por dy momente kryesore të shkresës do të doja ti veçoja. Në këtë Këshill, Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, Kuvendi pjesërisht, përfaqësuesi i Kryetarit se deputetët nuk kanë ardhur, ne kemi qenë prezent në të gjithë vitin, pa përjashtim në asnjë mbledhje. Dhe kur kemi patur të paktën ne si Institucion ndonjë çështje që nuk na ka pëlqyer, në vlerësimin tonë nuk është trajtuar siç duhet, e kemi bërë present, edhe gjatë fazës së hartimit të akteve, por e kemi ndërprerë këtë veprimtari në momentin që Këshilli ka filluar vlerësimin dhe verifikimin e kandidatëve sepse nuk është në tagrin tonë. Edhe në këtë rast Presidenti nuk ka vlerësuar vendimarrjen e Këshillit, as për pikëzimin, as për raportin vlerësues. Nuk ka thënë Presidenti përse ky kandidat ka kaq pikë, po ky kaq dhe apo ky vlerësim aq. Është marrë vetëm me arsyetimin e tij mbi pjesën fundore të procesit, të dërgimit të listave, që në vlerësim të Presidentit duhet të ishte dërguar më ndryshe. Më gjatë është e trajtuar me shkresë. Ajo që Presidenti ka si vullnet, unë dua ta them dhe ta përsëris dhe proces-verbali ta zbardhë, është vullneti për tu shprehur ekziston pa asnjë vonesë në vakancën e parë, brënda një jave. Vullnetit për të mospenguar Kuvendin e Shqipërisë që të ketë dhe ai mundësi të zgjedhë ekziston sepse jo me kot dy ditë pasi administroi listat bëri një pyetje në KED se a i ka administruar Kuvendi listat e tij për vakancën e parë dhe për vakancën e dytë, me qëllim që Kuvendi të administronte kandidat, pavarësisht se arsyetimet janë të ndryshme, tre për secilën vakancë. Edhe këtu është luajalitet. Presidenti vlerësoi vetëm veprimtarinë administrative fundore të Këshillit që u vlerësua dhe nga Këshilli setashmë tani do të plotësohet dhe me dërgimin e dokumentacionit dhe ka vullnet dhe do të shprehet sipas rradhës që dikton Kushtetuta, neni 179, pika 2 dhe 12 e Kushtetutës. Vlerësimet e secilit organ janë të tij. Është e vërtetë, edhe ju nëse do të bëni një vlerësim mbi qasjen e Presidentit do të hyni në atë që u

tha në diskutim mbi kompetencën dhe ne nuk e kemi bërë këtë, ne kemi bërë vetëm pjesën fundore të dërgimit të listave, e kemi bërë shumë të qartë. Kështu që ne e presim dokumentacionin e sjellë nga Këshilli dhe pasi Kuvendi të shprehet për zgjedhjen më së paku të anëtarit të dytë, ne do të shprehemi menjëherë për zgjedhjen e gjyqtarit të ri kushtetues që i takon për plotësim Presidentit të Republikës, pa asnjë vonesë.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi evidenton që këto ishin çështjet e programuara për shqyrtim në rendin e ditës dhe deklaron mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 14.05

Sekretare

Kryetari

Dorina Dulaj

Ardian Dvorani

Ermelinda Kadiu